



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2023:174046

Datë: 05.08.2024

Numri i dokumentit: 06017463

**2023:174047**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa , duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.26/24 të datës 25.07.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit B. K nga Kaçaniku dhe të dëmtuarit L. I. nga Kaçaniku, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.1077/23 të 11.08.2023 për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 05.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.26/24 të datës 25.07.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit B. K. nga Kaçaniku dhe të dëmtuarit L. I. nga Kaçaniku.

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1077/23 e datës 11.08.2023 dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit B. K. nga Kaçaniku, rr.”...” pn, i lindur me datë ..., me nr. personal: ..., për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.1077/23 e datës 11.08.2023, e ka akuzuar të pandehurin B. K. nga Kaçaniku, për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 25.07.2024, palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si 2023:174047, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 25.07.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.26/24, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit B. K. dhe të dëmtuarit L. I.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

### **DEGA KAÇANIK**

**2023:174047 datë, 05.08.2024**

Sekretarja Juridike

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.